

277
03.04.2014
DRILL



Datë: 20.03.2014

Obiliq



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë • Gjakovë

MEMORANDUM BASHKPUNIMI LIDHUR NË MES:

Institutit "Inkos"sh.a në Obiliq
Dhe
Kolegji"Biznzesi"- Prishtine

Memorandumi i bashkëpunimit ka për qëllim sigurimin e bashkëpunimit në mes të subjekteve nënshkruese, të vetëdijshëm se një bashkëpunim i tillë është i domosdoshëm për arritjen e qëllimeve të avancimit shkencor per mes edukimit dhe hulumtimit te programeve te qëndrueshme akademike dhe shkencore te përbashkëta.

Neni 1 **Qëllimi**

Qëllimi i këtij memorandumi është ngritja e kapaciteteve, cilësisë dhe aftësive profesionale në këto dy institucione dhe shkëmbimi i eksperiencave nga lëmit gjegjëse.

Neni 2

Të dy palët zotohen për të ndihmuar në punët e përbashkëta në fushat gjegjëse të përbashkëta dhe aktivitetave studentore dhe akademike te pjese hulumtuase dhe punë të tjera.

Neni 3 **Obligimet e Kolegjit " Biznesi"**

Kolegji "Biznesi" obligohet të mbështes me kuadrin akademik dhe teknikën e saj ne fushën e emergjencave Institutin "Inkos" sh.a. duke ofruar shërbimet dhe përvojën akademike në Mbrojtje ne pune, mbrojtjen kundër zjarrit dhe ne fushën e hulumtimeve dhe planifikimeve te Programeve te Emergjencave dhe Planifikimit preventive si dhe menaxhimet me rastin e situatave emergjente si dhe punë të tjera profesionale të kësaj lëmie.

Neni 4
Obligimet e Institutit “Inkos”sh.a

Instituti “Inkos”sh.a. obligohet që të mbështes Kolegjin “Biznesi” duke i mundësuar pranin e studenteve ne objektet dhe laboratorët si dhe pajisjet – instrumentet për matje me qellim te avancimit te dijes në projektet e saja duke angazhuar kapacitetet e veta teknike profesionale në fushën e hulumtimeve në lëmit e mbrojtjes ne pune dhe emergjencë si dhe ujit, ajrit dhe tokës sipas kërkesave dhe nevojave për tregje të përbashkëta.

Neni 5

Palët nënshkruese të këtij memorandumi marrin obligim që të informojnë rregullisht njëra tjetërën lidhur me projektet dhe angazhimet e tyre dhe të dërgojnë ftesat përkatëse të bashkëpunimit në pjesëmarrjen e përbashkët në Projektet.

Neni 6

Palët u akorduan që përfaqësuesit e tyre të takohen kohë pas kohe për të shqyrtuar përbushjen dhe nivelin e zbatimit të këtij memorandumi. Në rast se palët vlerësojnë se marrëveshja duhet të ndryshohet apo të plotësohet secila palë mund të propozoj projekt-amendamente dhe me pëlqimin e dyanshëm amendamentet e propozuara mund të miratohen.

Neni 7

Ky memorandum nënshkruhet me zgjatje për një kohë të pacaktuar. Secila prej palëve mund të tërhiqet nga ky memorandum me kusht që të njoftoj palën tjetër të paktën 30 ditë më parë.

Neni 8

Mosmarrëveshjet eventuale gjatë interpretimit të dispozitave të këtij memorandumi palët i zgjidhin me bisedimet e përbashkëta pa pasur nevojë t’i drejtohen ndonjë ndërmjetësi apo organeve të sistemit gjyqësor në Kosovë.

Neni 9
Zbatimi

Palët pajtohen se do të përkujdesen për zbatimin e këtij memorandumi me përkushtim dhe përpikëri.


Neni 10

Ky memorandum është nënshkruar në katër (4) ekzemplarë të njëjtë, të firmosura në origjinal nga titullarët dhe të vulosura me vulat zyrtare të palëve pjesëmarrëse.

Neni 11

Ky memorandum hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga të dy palët.

Drejtori i Institutit “Inkos” sh.a.
Mahedin Haxhiu,inxh.dip.xeht



Dekani i Kolegjit “Biznesi”
Prof. Dr. Shyqeri Kabashi

